

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN PËR MOS NDARJEN NË LOTE TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale për nevoja spitalore MM2”

VLERA E FONDIT LIMIT: **1,316,642,915.80** (një miliardë e treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje tetëdhjetë lekë) **lekë pa tvsh** ose: 14,272,551.93 (katërmëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e tre) euro pa TVSH sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 27.08.2026 ku Euro këmbëhet me 92.25 Lekë.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 ku prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të

arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Njësia e Prokurimit sqaron se procedura e prokurimit është procedurë e rishpallur, pasi procedura e prokurimit me objekt “LOT 2 – Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2”, me nr. REF-89793-06-11-2026 me fond limit 1,316,642,915.80 (një miliardë e treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje tetëdhjetë lekë) lekë pa tvsh ose 13,852,108.53 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetë presje pesëdhjetë e tre) euro pa TVSH, u anulua në zbatim të Vendimit Nr. 937/2026 datë 03.08.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe Vendimit Nr. 125/2026, datë 16.07.2026 të KSHA.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sa i takon ndarjes në lote të procedurës së prokurimit, nëpërmjet vendimit të sipërcituar, argumenton si më poshtë:

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK për rishikimin e strukturës së procedurës së prokurimit dhe ndarjen e saj sipas institucioneve përfituese ose sipas grupeve funksionale të spitaleve, në përputhje me nevojat reale të secilit autoritet kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik

III.5.1. Referuar dokumentit të titulluar “Loti 2 _ Aneks 1 për MM2”, i cili është pjesë përbërëse e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), evidentohen qartë institucionet spitalore përfituese për nevojat e të cilave zhvillohet kjo procedurë prokurimi, e cila është objekt ankimi. Ky dokument dëshmon se Autoriteti Kontraktor ka grumbulluar në një lot të vetëm nevojat e disa institucioneve të ndryshme, pa kryer ndarjen e tyre sipas spitaleve apo grupeve funksionale, duke rënë kështu në kundërshtim me parimin e moskufizimit të konkurrencës dhe efektivitetit të fondeve publike.

III.5.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit “162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuat, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- h) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.5.3. Neni 39 i ligjit “162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke

përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.”

Në nenin 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sectorial.

III.5.4. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton se objekti I prokurimit është Blerje materiale mjekimi të përgjithshme dhe kirurgjikale për nevoja spitalore” e ndarë në dy lote” Loti 2 “Blerje materiale mjekimi konsumi kirurgjikale MM2”. Referuar dokumentit të titulluar “Loti 2 _ Aneks 1 për MM2”, i cili është pjesë përbërëse e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik

(SPE), evidentohen qartë institucionet spitalore përfituese për nevojat e të cilave zhvillohet kjo procedurë prokurimi, e cila është objekt ankimi. Ky dokument dëshmon se Autoriteti Kontraktor ka grumbulluar në një lot të vetëm nevojat e disa institucioneve të ndryshme, pa kryer ndarjen e tyre sipas spitaleve apo grupeve funksionale.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “SoLed” SHPK për ndarjen në lote të procedurë komisioni gjykon se grumbullimi i të gjitha nevojave spitalore në një lot të vetëm krijon një volum të madh porosie. Kjo rrit interesin e prodhuesve dhe distributorëve të mëdhenj globalë për të marrë pjesë në garë, duke ofruar çmime shumë më të ulëta për njësi sesa po të ndaheshin në lote të vogla rajonale. Ndarja e tenderit në lote gjeografike (Veri, Jug, Universitare) do të zvogëlonte volumin e secilit lot. Për pasojë, operatorët ekonomikë do të rritnin çmimet e ofertave për lotet më të vogla ose gjeografikisht më të largëta (p.sh. Kukës apo Gjirokastrë) për të mbuluar kostot e tyre të transportit dhe logjistikës. Kjo do të shkelte drejtpërdrejt parimin e efektivitetit të fondeve publike sipas LPP, duke bërë që shteti të paguajë më shtrenjtë për të njëjtin produkt. Fluksi i operacioneve dhe rasteve kirurgjike të urgjencës është dinamik dhe i paparashikueshëm. Nëse materialet ndahen me lote të prera për çdo spital, një spital rajonal mund të përballlet me mungesa kritike (stock-out) për shkak të një fluksi të papritur, ndërsa një spital tjetër mund të ketë teprica që skadojnë në magazinë. Mekanizmi i rishpërndarjes qendrore: Mbajtja e një kontrate të vetme monolitike lejon Autoritetin Kontraktor (p.sh. Ministrinë e Shëndetësisë apo institucionin qendror prokurues) të bëjë alokim dhe rishpërndarje fleksibël të materialeve MM2 midis spitaleve në kohë reale, duke u bazuar në nevojat urgjente klinike dhe jo në barriera burokratike kontratash të ndara. Çdo qytetar shqiptar, pavarësisht nëse operohet në një spital Universitar në Tiranë apo në një spital Rajonal në rrethe, ka të drejtë të trajtohet me të njëjtën cilësi të materialeve të konsumit kirurgjikal. Përdorimi i një loti të vetëm garanton standardizimin e materialeve MM2 në mbarë vendin. Pretendimi se spitalet rajonale nuk kryejnë ndërhyrje specifike është i gabuar dhe i rrezikshëm. Spitalet rajonale duhet të jenë të pajisura në çdo moment me materiale të teknologjisë së lartë për të përballuar urgjencat kirurgjike të cilat nuk premtojnë kohë për t'u transportuar drejt Tiranës (p.sh. trauma nga aksidentet). Mungesa e këtyre materialeve në rrethe do të vinte në rrezik jetën e pacientëve. Përvoja në prokurimet publike tregon se lotet e vogla gjeografike ose lotet me artikuj tejet specifike shpesh nuk tërheqin interesin e operatorëve ekonomikë, duke çuar në dështimin e procedurës për ato lote. Mbajtja e tyre brenda një loti të madh dhe të qëndrueshëm garanton që asnjë spital rajonal të mos mbetet pa furnizim. Menaxhimi, monitorimi dhe auditimi i një kontrate të vetme të madhe është administrativisht shumë më i kontrollueshëm sesa menaxhimi i dhjetëra kontratave të ndryshme me operatorë të ndryshëm, gjë që do të mbingarkonte stafin e spitaleve dhe do të rriste vonesat burokratike në lëvrim.. Ligji i Prokurimit Publik nuk e ndalon bashkimin e nevojave të institucioneve të ndryshme kur kjo sjell përfitime ekonomike dhe menaxhuese. Përkundrazi, prokurimi i përqendruar është një instrument ligjor i njohur që synon shfrytëzimin maksimal të fondeve publike përmes ekonomisë së shkallës. Gara nuk kufizohet, pasi çdo operator që ka kapacitet furnizimi në nivel kombëtar mund të konkurrojë lirisht, ndërsa operatorët mund të bashkohen si Bashkim Operatorësh Ekonomikë (BOE) për të përmbushur

kriteret.

Për sa më sipër, në kushtet kur ndarja e mëtejshme në lote nuk është lejuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, Njësia e Prokurimit, në zbatim të Vendimit Nr. 937/2026, datë 03.08.2026 të KPP, gjykon se procedura duhet të vijojë në strukturën e përcaktuar, pa ndarje të mëtejshme në lote.

NJËSIA E PROKURIMIT